

DEKLARIMI DHE VERIFIKIMI I PASURISË SË ZYRTARËVE TË LARTË ZBATIMI I LIGJIT MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Hartuar nga: QENDRA PËR TRANSPARENCËN DHE INFORMIMIN E LIRË
www.qtil.altirana.com
report_reporter@yahoo.com

Financuar: Ambasada Britanike, Tiranë (Global Opportunities Fund)

RAPORT I PLOTË 1 PRILL 2006-31 MARS 2007

Përmbajtja:

- 1- Hyrje
2. Metodika
3. Prezantimi i rezultateve
4. Konkluzione
5. Propozime
6. “Memo” mbi “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”
7. Falënderim

Hyrje

Raporti i mëposhtëm paraqet të dhëna rreth zbatimit të ligjit mbi pasurinë e zyrtarëve të lartë dhe atë mbi konfliktin e interesit; statistika lidhur me korrektësinë e plotësimit të formularit të deklaramit të pasurisë; të dhëna rreth shmangies së deklaramit, kjo e shpërndarë sipas kategorive të zyrtarëve.

“Watch Dog 2006-2007”, në përbërje të Qendrës për Transparencë dhe Informimin e Lirë, ka synuar dhe realizuar verifikimin e pasurive të zyrtarëve të lartë, identifikimin e rasteve, prezantimin e tyre tek institucionet përgjegjëse dhe reagimin e tyre, implementimin e ligjit për konfliktin e interesit, identifikimin e rasteve me konflikt interesi, etj., sipas parimeve statistikore, duke arritur rezultate të besueshme pas seleksionimit të pothuajse 3% të deklaratave të pasurisë dhe konfliktit të interesit.

Puna është kryer nga një grup “Watch Dog”, në përbërje të Qendrës për Transparencë dhe Informim të Lirë. Anëtarët e “Watch Dog” janë gazetarë, juristë, vlerësues pasurie dhe avokatë të çështjeve civile. Investigimi është zhvilluar përgjatë një viti, duke filluar në prillin e 2006-s deri në fund të marsit të 2007-s.

Gjetjet janë arritur përmes investigimeve dhe ekspertizës. Subjekte të zbatimit të ligjeve të mësipërm janë rreth 4200 zyrtarë të lartë apo të mesëm të administratës shqiptare. Ata janë të detyruar të deklarojnë pasuritë e tyre, si dhe pozicionin që ata kanë në raport me detyrën që kryejnë në administratën publike.

Projekti është mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë (Global Opportunities Fund).

Rezultatet e paraqitura në këtë raport, por edhe të gjashtëmujorit, tashmë të publikuar dhe të konsultuar nga disa institucione, do t’i shërbejnë zbatimit të ligjeve të mësipërme nga administrata shqiptare, institucioneve kontrolluese të zbatimit të këtyre ligjeve, luftës kundër korrupsionit në administratë, e rrjedhimisht edhe qytetarëve shqiptarë.

Perceptimi i korrupsionit në Shqipëri është ende mjaft i lartë. Pothuajse nuk ka shumë vështirësi për të gjetur qindra raste të korrupsionit të zyrtarëve të niveleve të ndryshme. Korrupsioni është direkt me para në dorë, korrupsion në tendera, prania e konfliktit të interesit, ndërtimi i ligjeve konform interesave të grupeve të vogla etj. Dy prej ligjeve të miratuar nga Parlamenti, ai për deklarimin e pasurive të zyrtarëve të lartë 2003, dhe ai mbi konfliktin e interesit 2005, synojnë kontrollin e pavarur mbi administratën, kufizimin dhe identifikimin e mundshëm të rasteve të fshehjes së pasurive apo konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë.

Metodika

Janë seleksionuar 106 funksionarë të lartë të administratës, deputetë, qeveritarë, prokurorë dhe gjykatës, ose ndryshe 2.6% e zyrtarëve që kanë detyrim deklarimin e pasurisë. Kriteri i përzgjedhjes është bazuar mbi perceptimin e korrupsionit në Shqipëri dhe hallkat ku ai është më i pranishëm, ose është më lehtë të realizosh një proces korrupsioni.

Qeveria: U zgjodhën pjesa më e madhe qeverisë, një pjesë e ish-qeverisë së mëparshme me aktivitet politik aktiv në opozitë, por edhe nga ata ish-ministra që nuk kanë më aktivitet.

Deputetë: Është grupi më i lartë i të zgjedhurve. Grupi vendosi të përqendrohej te deputetët, pasi gjatë një shorti të kryer nga Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive, vetëm një deputet ishte në grupin e zyrtarëve që do të kontrolloheshin prej tij. **Administrata e Lartë:** Drejtuesit kryesorë të drejtorive që disbursojnë më shumë para për tendera, shpenzime etj.; drejtoritë që kanë objekt kontrollin apo supervizionin; disa zëvendësministra në ministrinë me buxhetin më të madh.

Prokurorë: U zgjodhën drejtuesit e disa prokurorive dhe disa shefa zyrash në Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjykatës: Anëtarë të Gjykatës së Lartë, KLD-së, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës në Tiranë, si dhe ish-Gjykatës

Administrata Lokale: U përzgjedhën disa kryetarë komunash dhe bashkish me ritëm më të madh zhvillimi apo investimesh, siç janë disa komuna bregdetare dhe disa të tjera rreth Tiranës.

Përpunimi i të dhënave:


Tre ekspertë kanë kryer kontrollin ligjor, financiar dhe atë të pasurisë së deklaratave progresive që nga vitit 2004 e deri në marsin e 2006-s (ka raste kur deklaratat janë fillestare). Më pas janë seleksionuar grupi i deklaratave që do të investigohen me thellë

bazuar në të dhënat e përfituara nga deklaratat. Grupi investigues ka kryer kontrolle në terren, si dhe ka ndjekur sjelljen institucioneve lidhur me rastet e konstatuara, si shkelje të rënda në deklarimin e pasurisë apo konfliktin e interesit.



Të dhënat janë hedhur në një database, prej së cilit janë përfituar përgjigje të ndryshme lidhur me pasuritë e zyrtarëve të lartë.

-Përzgjedhja, sipas administratave aktuale dhe të kaluar, është bërë si më poshtë: 35% zyrtarë të lartë; 10% ish-ministra; 10% ministra; 9% prokurorë; 14% gjykatës. (*shih fig*):


tab 1.1



Ndërsa përfaqësimi politik i tyre është si më poshtë: 48% i përkasin mazhorancës; 15% opozitës; 2% përfaqësues të partive të vogla politike, ndërsa 35% janë zyrtarë pa përkatësi partiake apo emërimë, për shkak të ndërrimit të qeverisjes. (*shih fig*)



Ndërsa përqindja e deputetëve të investiguar dhe të kontrolluar është 24%.




Vijojnë të dhënat statistikore në disa indikatorë të vlerësuar nga kontrolli i ekspertëve apo investigimi i mëtejshëm:


Gabimet në plotësimin e deklaratave të pasurisë: Çdo gabim është vlerësuar në dy shkallë, gabim i lehtë dhe gabim i rëndë; rasti i parë konsiderohet kur gabimet e bëra janë teknike, por mund të çojnë dyshime të fshehjes së pasurisë, ndërsa rasti i dytë konsideron se gabimi është i lidhur me fshehje të pasurisë në asete, asaj financiare, apo konflikt interesi, gjë që kuptohet që në analizën e deklaratës së pasurisë. (Rivlerësimi i gabimeve teknike dhe të rënda do të bëhet edhe më poshtë, bazuar në matjen e indikatorëve të tillë





si gabime me fshehje pasurie, gabime financiare me fshehje të të ardhurave, gabime me fshehje të konfliktit të interesit).

Rezultatet e kërkimit tregojnë se kemi 38 zyrtarë me gabime teknike, 13 zyrtarë me gabime të rënda dhe 55 zyrtarë me deklarata të plotësuara në rregull. (Kjo matje nuk do të thotë se deklaratat e plotësuara në rregull nuk paraqesin probleme të shkeljes së pasurisë), (shih fig)




Ndërkaq matja e gabimeve të specifikuar me rezultate në fshehje të pasurisë apo asetëve është si më poshtë: 9 raste me fshehje pasurie, 26 raste me gabime financiare, si për shembull zhbalancim i të ardhurave me asetet financiare apo të tjera, dhe 32 raste me gabime të pasurisë që çojnë në nënvlerësim apo mbivlerësim të çmimit kryesisht për asetet (shih fig)








Sipas kategorive politike të zyrtarëve të konsideruar me profil apo emërtesë politike, atyre pa profil politik; gabimet, fshehjet e aseteve apo relatimet e dyshimta financiare janë si më poshtë: mazhoranca ka më shumë gabime teknike dhe gabime të rënda me theks te gabimet teknike; opozita ka një fluks më të vogël të gabimeve të teknike dhe të rënda, ndërsa zyrtarët pa profil politik kanë një fluks të mesëm të gabimeve, por më të vogël se zyrtarët me profil politik.

Bar Chart




Siç do të vërehet më poshtë, i njëjti raport ruhet edhe në indikatorët e tjerë të matur nga ekspertët e të verifikuar nga grupi i investiguesve, lidhur me gabimet që çojnë fshehje të aseteve, fshehje të të ardhurave financiare, apo vlerësime të gabuara të pasurisë në raport me çmimin e tregut, sipas periudhës përkatëse. Megjithatë, duhet veçuar fakti se në dy indikatorë, atë të fshehjes së pasurisë dhe gabimeve financiare, zyrtarët pa profil politik kanë të dhëna më pozitive.





Ndërkaq matja dhe investigimi i deklarimeve dhe asetëve të të gjithë grupeve të zyrtarëve është si më poshtë: ministrat, ish-ministrat nuk janë “zënë” në gabime të rënda në rastin e kontrollit të deklaratave, por kjo nuk ka ndodhur edhe në rastin e investigimit të mëtejshëm. Ndërkaq, gjykatësit, prokurorët, kryetarët e bashkisë, kryetarët e komunave dhe zyrtarët lokalë kanë më së shumti gabime të rënda. Në krye qëndrojnë kryetarët e bashkive. Ndërkaq asnjë kryetar komune i investiguar nuk ka një deklaram të rregullt të pasurisë, ndryshe nga të gjitha kategoritë e tjera të zyrtarëve (shih fig).

Bar Chart




Në rastin e indikatorëve të tjerë, ruhet në njëfarë mase e njëjta pamje si në grafikun e mësipërm; me fshehje pasurie kemi raste të drejtuesve lokalë dhe ish-ministrave. Zyrtarët e lartë nuk kanë fshehje të pasurive të patundshme, por kanë shmangie të të ardhurave financiare. (shih fig)


(Duhet theksuar përsëri që fshehja e pasurisë mund të kategorizohet në dy nivele, i pari fshehje pasurie për shkak të mosdeklarimit të të ardhurave, ndërsa tjetri fshehje pasurie për mosdeklarim të asetëve, tashmë pronë e zyrtarit apo të të afërmeve të zyrtarit.

Shpeshherë një pasuri e tillë edhe nuk është regjistruar. Megjithatë parashikohet që të bëhet deklarimi edhe i pasurive informale).


Bar Chart



Bar Chart




Bar Chart




Deputetët


“Watch Dog” ka kontrolluar apo investiguar 24 deputetë. Më poshtë paraqitet sjellja e tyre në raport me secilin prej indikatorëve të matur për vlerësimin e zbatimit të ligjit për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesit. Në figurë është bërë krahasimi i gabimeve të deputetëve me të gjithë zyrtarët e tjerë. Vëmë re se deputetët kanë shumë pak gabime të rënda, por kanë një numër të konsiderueshëm gabimesh teknike. Krahasuar me “Watch Dog” të kryer në vitin 2004, deputetët kanë rritur ndjeshëm korrektesën e deklarimit të pasurisë, plotësimin e formularit dhe kujdesin që pasuritë e tundshme dhe të patundshme të raportohen në mënyrë të qartë.




Në rastin e deklarimit me fshehje të pasurisë shihet qartë se edhe pas investigimit, numri i deputetëve me probleme pasurore, sipas këtij indikatori, është i vogël.




Por gabimet financiare janë më frekvente gjatë kontrollit apo investigimit. Po ashtu edhe gjatë vlerësimit të indikatorit që ka të bëjë me gabime të pasurisë (*shih fig*)





Konflikti i interesit: Nga deklaratat dhe verifikimi në terren konsiderohet konflikte të qarta interesi në 9 raste. Më të shpeshtat janë rastet kur zyrtari i lartë ka marrë një shtëpi nga Enti i Banesave dhe më pas ka përfituar një kredi shtetërore me interesa të ulëta si i pastrehë. Bëhet fjalë kryesisht për ish-ministra dhe deputetë, ndërsa rasti më flagrant i konfliktit të interesit ka të bëjë sërish me banesa dhe ku është i përfshirë një deputet. Rasti është paditur në prokurori, por ende nuk ka një vendim lidhur me zgjidhjen e konfliktit.


Konflikt interesi në raste biznesi është identifikuar në një rast. Duhet theksuar fakti se prania e konfliktit të interesit të përfaqësuesit e opozitës nuk ka të bëjë me situatën aktuale, por me raste të konfliktit të interesit hasur gjatë periudhës kur në pushtet ishte PS-ja. Ato janë përfshirë në kërkim, për shkak se nuk janë shmangur dhe qëndrojnë ende si të tilla. Theksojmë faktin se një rast i tillë konflikti interesi është në prokurori. Më poshtë tabela shpjegon shtrirjen e konfliktit të interesit në rastet e investigimit.




Ndër rastet e konfliktit të interesit më të theksuara janë ato që kanë qenë raste të vjetra, por nuk janë korrigjuar. Kjo është edhe arsyeja që grafiku duket pak absurd, për shkak se rëndon te opozita më shumë se te mazhoranca, e cila realisht ka ambient për konflikt interesi.

Megjithatë, konflikt interesi janë hasur shpesh edhe në administratën e re, por korrigjimi është bërë shpejt. Tipik është rasti i Ministrisë së Shëndetësisë, ku të paktën 14 raste të konfliktit të interesit janë shuar vetëm pak ditë pas identifikimit të tyre. Ndërkaq duhet theksuar se një rol të madh ka pasur Inspektorati i Lartë i Pasurisë që ka identifikuar brenda një viti mbi 100 raste, të cilat më pas janë zgjidhur.

Figura më poshtë tregon se si është shpërndarë konflikti i interesit mbi të gjitha kategoritë e zyrtarëve. Bie në sy se ai është më i theksuar në sistemin e drejtësisë dhe në qeveri apo ish-qeveri.



Ndërsa konflikti i interesit te deputetët në raport me zyrtarët e tjerë është si më poshtë:



Propozimet:

-Duhet amenduar menjëherë amnistia, që përfshin edhe zyrtarët me deformime në procesin e deklarimit të pasurive. Për këtë u propozoj të gjitha OJQ-ve të përfshira në luftën antikorupsion për të përgatitur një projekt amendimi te ligjit për amnistinë në janar të këtij viti.

Prokuroria të veprojë me procedurë të përsheptuar në rastet e padive të deklarimit të pasurive.

Inspektorët e ulët në administratë të emërohen nga Inspektorati i Lartë dhe të jenë të pavarur nga ministria apo institucioni ku ata do të atashohen. Inspektorët e ulët nuk duhet të kryejnë punë tjetër në institucion siç është praktika deri tani ku drejtorë të administratës shërbejnë edhe si inspektorë. Kjo, për shkak se ata paguhen keq, kanë konflikt interesi me shefat e tyre, nuk e kryejnë mirë punën dhe nuk kryejnë seanca trajnimi me zyrtarët për plotësimin e formularit.

Që nga fillimi formulari ka pasuar ndryshime, duke lehtësuar plotësimin e tij dhe të kuptuarit e kërkesave nga zyrtarët e detyruar ta plotësojnë. Me gjithë përmirësimet që i janë bërë formularit është e domosdoshme që ai të lehtësonte edhe më tej. Sa më i lehtësuar dhe i thjeshtë të bëhet ai,

aq më lehtë plotësohet nga zyrtarët dhe aq më vështirë bëhet për këta të fundit të shmangin detyrimet e deklarimit.

Zyrtarët nuk njohin si duhet ligjin e deklarimit të pasurive dhe detyrimin e tyre për të deklaruar pasuritë. Ata duhen trajnuar përpara deklarimit.

Zyrtarët e administratës që kanë jetuar jashtë vendit në disa raste kanë bërë deklarime të pasurisë në shuma të mëdha dhe mbi logjikën e të ardhurave. Duhet gjetur rrugët e investigimit të zyrtarëve që vijnë nga jashtë dhe kanë pasuri të dyshimta. Në disa raste kjo është bërë nga ana e inspektoratit, por ka disa raste të tjera kur procedura është mjaft e ndërlikuar, sidomos në rastet kur pasuria e deklaruar është nga aktivitete private dhe jo institucionale.

Duhet ndërprerë çdo tentativë e zyrtarëve apo deputetëve për të reduktuar transparencën e deklarimit të pasurive apo konfliktit të interesit. Kjo nëpërmjet sensibilizimit të publikut dhe medias, lidhur me rëndësinë e kësaj transparence për të luftuar korrupsionin dhe abuzimet.

Konkluzionet

Grupi “Watch dog” ka kontrolluar dhe verifikuar 106 deklarata të zyrtarëve të lartë të administratës dhe gjyqësorit. Numri i deklaratave të investiguara përbën 2.5 % të të gjithë numrit të deklaratave të pasurisë, bërë nga zyrtarët e lartë sipas ligjit.

Metodika e seleksionimit të personave të investiguar është kryer duke pasur parasysh vendet e punës dhe zyrat që drejtojnë dhe jo personat që kryejnë këto detyra. Është synuar zgjedhja e një numri të madh deputetësh, të cilët si kategori pothuajse nuk u përfshinë nga shorti i kryer në ILDKP-në (Inspektorati i lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive). Nga 106 zyrtarë, 24 prej tyre janë deputetë, 11 janë ministra, 10 janë ish-ministra. Në seleksionim është mbajtur parasysh që asnjë prej anëtarëve të “Watch dog” të mos ketë konflikt interesi me të përzgjedhurit.

Gjykatësit dhe prokurorët zënë një vend të konsiderueshëm në investigim, rreth 23 % të numrit të totalit, ndërsa mes tyre gjykatësit kanë vendin më të madh, rreth 14%.

Ky është “Watch dog” i dytë lidhur me verifikimin e pasurive të zyrtarëve, që kur ka filluar implementimi i ligjit të deklarimit të pasurisë në vitin 2003. Kontrolli është bërë mbi deklaratat progresive, pra për të gjitha deklaratat dhe ndryshimet e tyre përgjatë viteve 2003-2006 (për të gjithë ata që e kanë pasur këtë detyrim përgjatë tre viteve). Nga një analizë krahasuese mes dy investigimeve konstatojmë se: është rritur serioziteti i deklarimeve, pra nuk ka nënvlerësim të deklarimit; është ulur niveli i gabimeve teknike, por edhe i gabimeve të rënda; është rritur vlera e pasurisë së deklaruar; nuk janë shmangur konfliktet e interesit në krijimin e pronës përgjatë këtyre tre viteve; nuk janë deklaruar pasuri të padeklaruara dhe të konstatuara si të tilla gjatë viteve të mëparshme; nuk janë riparuar deklarime nën kosto të shtëpive apo pasurive të tjera; vijnë me të njëjtin ritëm fshehja e pasurisë në momentin e shitjeve dhe blerjeve.

Puna e Inspektoratit të Lartë të Pasurive është e lavdërueshme, veçanërisht në rastin e implementimit të ligjit të Konfliktit të Interesave. Për shkak të ndërhyrjes së tij janë shmangur 113 raste të konfliktit të interesit në administratë.

Në përgjithësi, zyrtarët me profil politik kanë më së shumti pasuri të pajustificuar, ndërsa zyrtarët pa profil politik kanë pasuri të ndryshme në termat e deklarimit të të ardhurave. Megjithatë, tek këta të fundit vihet re një shmangie në të ardhurat financiare.

Llogaritë bankare të zyrtarëve të lartë nuk pësojnë ulje, por janë gjithnjë ose në rritje ose konstante, pavarësisht shpenzimeve. Në disa deklarata të tre viteve të fundit, kredia e marrë për efekte strehimi është depozituar në banka dhe nuk është prekur asnjëherë.

Disa zyrtarë lokalë kanë shfrytëzuar haptas detyrën për pasurim vetjak.

Vazhdon mosdeklarimi i pasurive informale, mosdeklarimi i bilanceve për ata që kanë biznese private, ose kur këto të fundit deklarohen, referencat janë negative.

Deklaratat e pasurisë vazhdojnë të plotësohen me gabime. Ka mungesë kujdesi dhe zbatimi të ligjit nga inspektoratet e ulëta të ngritura në institucione. Ka gabime të rënda, të cilat duhet të rishikoheshin nga zyrtarët ose t'u kërkohej shpjegime rreth këtyre gabimeve të rënda, të cilat lënë të kuptohet qartë mundësia e abuzimit me pasuritë e vëna.

Nga deklaratat dhe verifikimi në terren konsiderohen konflikte të qarta interesi në disa raste. Më i shpeshti është kur zyrtari i lartë ka marrë një shtëpi nga Enti i Banesave dhe më pas ka përfituar një kredi shtetërore me interesa të ulëta si i pastrehë. Ka raste të tjera kur pasuria është vënë për shkak të konfliktit të interesit, siç është rasti i disa kryetarëve të komunave apo bashkive.

MEMO 1

Mbi ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe ndryshimet që ka pësuar ky ligj.

1. Mbi ndërtimin strukturor të ligjit. (Teknika legjislativë)
2. Mbi përmbajtjen e ligjit
3. Mbi produktivitetin e ligjit dhe mënyrën e aplikimit të tij nga instancat shtetërore.
4. Mbi defektet dhe kundërthëniet e ligjit.

5. Ndërthurjet dhe kundërvëniet e këtij ligji me ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

6. Mbi amnistinë e nxjerrë nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 30.12.2006 që mbron cënuesit e këtij ligji.

(zhvillimi i detajuar i rubrikave të mësipërme)

Rubrika 1

Nga pikëpamja e ndërtimit, ligji në fjalë ka ndjekur ecurinë normale strukturore të ligjeve në përgjithësi, duke pasur këtë rend praktik:

a-Hyrja e ligjit, në të cilin janë përcaktuar qëllimi që kërkon të arrijë ligji.

b-Objekti dhe fusha e zbatimit të ligjit, në krye të ligjit janë vënë dhe përkufizimet e termave dhe koncepteve që përbëjnë lëndën (materien) e ligjit.

c- Është përcaktuar procedura dhe mjetet për identifikimin dhe regjistrimin e konflikteve të interesave.

-Janë evidentuar kufizimet e interesave private për parandalimin e konflikteve të interesave në çështje dhe raste të veçanta.

-Është përcaktuar procedura e trajtimit dhe e zgjidhjes së konfliktit të interesave.

-Është përcaktuar natyra e pavlefshmërisë së akteve të marra në kushtet e konfliktit të interesave dhe pasojat e tyre.

-Janë përcaktuar institucionet përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave.

-Janë përcaktuar sanksionet që duhen aplikuar kundër shkelësve të këtij ligji.

-Janë përcaktuar afatet për zbatimin e detyrimeve të ligjit.

2

-Mënyra e lidhjes së këtij ligji me ligjin mbi deklarimin e pasurive.

-Hyrja në fuqi e ligjit dhe dispozitat e fundit.

Nga pikëpamja formalo-juridike, ligji ka ndjekur rrugën normale të ndërtimit strukturor dhe ka përcaktuar të gjitha elementet, pjesë përbërëse të një ligji normal.

Rubrika 2

Përmbajtja e ligjit është konkrete, ajo rrok një gamë të madhe çështjesh që merr përsipër t’i rregulloj;

- ka një konceptim shumë të mirë të termave se ç’është konflikti i interesit për zyrtarin publik, mënyrat e shfaqjes së konfliktit të interesit;

- kur kemi konflikt të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë interesi;

- rrethi i personave që mund të ndikojnë në lindjen e konfliktit të interesit;
- rastet e veçanta të shfaqjes së tij;
- mënyrën e lidhjes së kontratave dhe rastet e pavlefshmërisë së tyre në rastet e shfaqjes së konfliktit të interesit të zyrtarit;
- përjashtimet dhe kufizimet e interesave private të zyrtarit publik gjatë detyrës dhe mënyrat e eliminimit të rasteve të konfliktit të interesit;
- detyrat dhe kompetencat e organeve eprorë të zyrtarit me konflikt interesi.

Teknika legjislativë

Ligji në vetvete është shumë i ngarkuar në formulime dhe shumë i vështirë në zbatim e për pasojë dhe në implementim.

Ligji në pjesën dërrmuese të tij është vetëreferues, pra pjesa më e madhe e dispozitave të këtij ligji i referohen vetë dispozitave të këtij ligji, madje arrin deri aty sa dispozita të veçanta i referohen tre herë dispozitave pasuese ose paraardhëse, çka e bën ligjin mjaft të vështirë në evidentimin e kërkesave kryesore.

Problemi i referencave të dispozitave është shumë i tejkaluar në pjesën materiale të ligjit, atje ku janë fusha e zbatimit të ligjit dhe objekti i veprimtarisë së tij, por referencat mund të ishin të pranueshme dhe deri diku të paevitueshme në pjesën procedurale të ligjit, në atë pjesë që ka të bëjë me detyrat dhe kompetencat e organeve për kontrollin dhe zbatimin e ligjit, si dhe në pjesën e fundit të tij.

Rubrika 3

Ligji në kuptimin formal është përpjekje shumë serioze për të evidentuar dhe shmangur konfliktin e interesit të zyrtarëve publikë dhe paraqet zhvillim shumë serioz progresiv krahasuar dhe me ligjin “Mbi statusin e nëpunësit publik” dhe atë të “Deklarimit të pasurive...”.

Në ligj nuk janë definuar shumë mirë detyrat dhe kompetencat e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

Është përcaktuar sfera e detyrave dhe organeve të ndryshme shtetërore për të përcaktuar detyrat dhe ndjekur zbatimin e ligjit, por ka pasur nevojë për një minimum një Udhëzim të përbashkët për të gjithë organet dhe institucionet, për të unifikuar kompetencat dhe mënyrën e vënies në praktikë të këtij ligji.

MEMO 2

Amnistia dhe ndikimi i saj mbi shkelësit e këtij ligji.

Dhënia e amnistisë më datë 13.01.2007 nga Kuvendi i Shqipërisë për një seri veprash penale apo edhe për persona, të cilët janë duke vuajtur dënimet e dhëna nga Gjykatat Shqiptare për vepra të ndryshme penale përbënte në vetvete një rast të mirë për të ndikuar në rehabilitimin shoqërore dhe në uljen e tensioneve shoqërore, por ligjvënësit janë treguar të pakujdesshëm (për të mos thënë se kanë vepruar me qëllim) pasi në personat që kanë konsumuar veprat penale dhe që përfitojnë nga amnistia është përfshirë edhe vepra penale që ka të bëjnë me deklarimin dhe kontrollin e pasurisë së funksionarëve të lartë dhe e nëpunësve civilë.

Kështu, Neni 5 i ligjit 9678 date 13.1.2007 “Për dhënie amnistie” thotë:
“Pushohen ndjekjet penale për çështjet në hetim, për çështjet e pashqyrtuara nga gjykatat, si dhe për kallëzimet, që ndodhen në këto organe dhe në organet e rendit publik, për veprat penale të kryera deri më 31.12.2006, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë”.

Vepra penale:

Fshehja e të ardhurave; neni 180 Kodi Penal

“Fshehja apo tregimi i rremë i të ardhurave ose i objekteve që i nënshtrohen tatimeve dhe taksave, kur më parë janë marrë masa administrative, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

-Shuarja e ndjekjes penale ndaj këtyre personave që janë zyrtarë të administratës shtetërore për një vepër që ka të bëjë drejtpërdrejtë me detyrën e tyre është shembulli më i keq i klasës politike shqiptare që jepet për publikun e gjerë, kjo në përgjithësi për Kuvendin e Shqipërisë, pasi amnistia është miratuar me konsensusin e të gjitha forcave politike.

Aq më tepër ndikimi negativ i amnistisë që ka përfshirë dispozitat mbi fshehjen e pasurisë dhe të konfliktit të interesave për zyrtarët është ndier në zbehjen e besimit ndaj mazhorancës, e cila është zotuar përpara shqiptarëve për një politike të duarve të pastra dhe të çuarjes përpara të drejtësisë së të korruptuarve.

-Ky shembull tregon më së miri se politikanët shqiptarë, luftën dhe demaskimin që u bëjnë fenomeneve negative të shoqërisë dhe akuzave që shkëmbejnë ndaj njëri-tjetrit i kanë përfshirë vetëm në terrenin e luftës politike dhe i shmangen terrenit juridik dhe të dhënies llogari përpara Drejtësisë, e cila si një pushtet i pavarur duhej të funksionojë dhe të godasë të gjithë shkelësit e ligjit pa dallim ngjyre politike, përbërje shoqërore apo cilësie tjetër, pasi ajo vepron në emër të shoqërisë shqiptare dhe në të mirë të shoqërisë dhe shtetit ligjor e jo të klasës politike shqiptare.

Kjo amnisti veç ndikimit me imazhe në publik, ka pasur efekte konkrete juridike (pasoja juridike), pasi 4 personave zyrtarë ndaj të cilëve kishte filluar procedimi penal për këto

vepra penale me miratimin e amnistisë, procedimet janë pushuar dhe nuk mund të rihapen në një kohë të mëvonshme.

Të njëjtin efekt ligjor ka edhe ndaj personave të tjerë zyrtarë që mund të kenë konsumuar këtë vepër penale dhe materialet ndaj tyre kanë qenë në fazën e grumbullimit të fakteve ose në faza të tjera akoma më fillestare të hetimit administrativ, këto të shtrira në afatin kohor deri më 31.12.2006. Gjë që do të thotë se ndaj tyre nuk mund të ndërmerret asnjë hap për procedim penal për veprën penale të “fshehjes së të ardhurave”.